



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

MBI

**KRITERET DHE KËRKESAT PËR MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE TË
SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 89, datë 27.06.2016
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 142, datë 30.07.2018
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 99, datë 29.07.2020
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 166, datë 29.09.2022
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.07.2024*

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat, shoqërisë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (më poshtë shoqëri administruese) dhe fondeve të administruara prej tyre.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të pikës 2, të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 33, pika 11, të Ligjit nr.76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” si nenit 35, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

Neni 3

Kriteret për përzgjedhjen e shoqërisë audituese

1. Shoqëria audituese e shoqërisë administruese, në shtesë të kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” dhe në Ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, i ndryshuar, duhet të plotësojë edhe kriteret e mëposhtme:
 - a) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë në fushën e auditimit ligjor të subjekteve financiare që zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar;
 - b) Të paktën dy prej ortakëve ose të punësuarve të shoqërisë të kenë titullin profesional “auditues ligjor”;
 - b1. Shoqëria audituese duhet të ketë si pjesë të brendshme të strukturës së shoqërisë, burimet njerëzore me kompetencat e duhura profesionale për të kryer auditimin ligjor, ku në ekipin e auditimit të ketë minimumi 2 anëtare (pa përfshirë ortakun e angazhimit) të cilët të jenë me eksperiencë në mbikëqyrjen dhe/ose kryerjen e angazhimeve të auditimeve ligjore në institucione financiare;
 - b2. I njëjti ekip auditimi, të mos jetë i angazhuar në më shumë se dy auditime të shoqërive administruese;
 - c) Gjatë dy viteve të fundit, të mos i jetë kërkuar, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ribërja e auditimit të kryer prej tij sipas përcaktimeve të pikës 7 të nenit 33 të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” si dhe të pikës 4 të nenit 35 të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
 - d) Të mos jetë subjekt i masave disiplinore nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike sipas përcaktimeve të legjisllacionit në fuqi për auditimin ligjor, për aq kohë sa kjo masë është në fuqi;
 - e) Të mos ketë konflikt interesi me shoqërinë që auditon, sipas përcaktimeve të Ligjit “Për auditimin ligjor” dhe ligjeve të fushës.
2. “Ortaku kryesor i auditimit” ose të punësuarit e shoqërisë audituese me titull profesional “auditues ligjor” duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë në fushën e auditimit të subjekteve financiare që zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar;
 - b) Të mos kenë konflikt interesi me shoqërinë që auditon, sipas përcaktimeve të Ligjit “Për auditimin ligjor” dhe ligjeve të fushës.
3. Në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese, kriteret e përcaktuara në pikën 1, shkronja a) dhe b) dhe pikën 2, shkronja a) të këtij neni, duhet të plotësohen bashkërisht nga të dyja shoqëritë audituese, ndërkohë kriteret e tjera të këtij neni plotësohen nga secila prej shoqërive audituese.

Neni 4

Dokumentacioni i kërkuar

1. Për miratimin e shoqërisë audituese, shoqëria administruese paraqet pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare një kërkesë me shkrim të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Vendimin e asamblesë së aksionarëve të shoqërisë administruese për emërimin e shoqërisë audituese apo emërimin e shoqërive audituese kur auditimi do të kryhet në mënyrë të përbashkët nga dy shoqëri audituese;
 - b. Metodologjinë e propozuar të auditimit duke përfshirë theksin në fushat kryesore dhe qasja përkatëse e auditimit. Programin e auditimit të shoqërisë dhe ekspertët e jashtëm të angazhuar nga shoqëria audituese;
 - c. Letrën e angazhimit të shoqërisë audituese për aktivitetin e shoqërisë administruese në Shqipëri, si dhe për aktivitetin e konsoliduar të shoqërisë administruese e cila përveç angazhimit për përmbushjen e kërkesave ligjore në fuqi, duhet të përfshijë edhe trajtimin e çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për shoqëritë që janë subjekt i Ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”. Letra e angazhimit e shoqërisë audituese duhet të parashikojë edhe:
 - i. Komunikimin e shoqërisë audituese me strukturën përgjegjëse për auditimin e brendshëm të shoqërisë administruese;
 - ii. Letrën e drejtimit; si edhe
 - iii. Letrën e përfaqësimit.
 - d. Vërtetim nga Organizata profesionale e audituesve ligjorë/Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, që vërteton se:
 - i. shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese, është person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë; dhe
 - ii. Shoqëria audituese ose të paktën njëra prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese ka jo më pak se 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve);

d/1. Vërtetim nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), që vërteton se “ortaku kryesor i auditimit” ose të punësuarit e shoqërisë audituese/shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët, me titull profesional “auditues ligjor” kanë jo më pak se 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve);

- e. Vërtetim nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në nenin 3, pika 1, shkronja d) të kësaj rregulloreje nga shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese;
- f. Deklaratë për përmbushjen e kërkesës së parashikuar në nenin 3, pika 1, shkronja e) dhe pika 2, shkronja b) të kësaj rregulloreje nga shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese;
- g. Dokumente apo informacione shtesë të kërkuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- 1/1. Në rastin e auditimit të përbashkët nga 2 shoqëri audituese, për dokumentat e parashikuara në shkronjat b) dhe c), të pikës 1, të këtij neni, duhet të depozitohet një dokument i përbashkët. Për dokumentat e parashikuara në shkronjat e), f) dhe g) të pikës 1, të këtij neni, të dorëzohen për secilën nga shoqëritë audituese në rast auditimi të përbashkët.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit në gjuhë të huaj, ky i fundit paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar dhe duhet të shoqërohet nga kopja e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe.

Neni 5

Procedura për miratimin e shoqërisë audituese

1. Kërkesa dhe dokumentacioni i plotë për miratimin e shoqërisë audituese, depozitohet në Autoritet nga shoqëria administruese jo më vonë se data 31 korrik i çdo viti kalendarik.
2. Autoriteti nëse e gjykon të nevojshme, i kërkon shoqërisë administruese plotësim dokumentacioni dhe informacion shtesë brenda një afati të caktuar nga Autoriteti.
3. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, brenda 2 (dy) muajve nga data e paraqitjes së plotë të dokumentacionit miraton ose refuzon shoqërinë audituese të propozuar nga shoqëria administruese.

Neni 6

Refuzimi i shoqërisë audituese

Autoriteti mund të refuzojë shoqërinë audituese të propozuar nga shoqëria administruese, nëse:

- i. Nuk përmbushen kriteret dhe kërkesat e parashikuara në Ligjin nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, Ligjin nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe të kësaj rregullore;

- ii. Shoqëria audituese ose të paktën njëra prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese në rastet kur është kryer një kontroll i cilësisë së punës, është vlerësuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, nën notën C.

Neni 7

Ndryshimi i shoqërisë audituese

1. Ndryshimi i shoqërisë audituese, brenda vitit financiar për të cilin është miratuar, bëhet me miratimin paraprak të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Për këtë qëllim, shoqëria administruese duhet të depozitojë në Autoritet dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Kërkesën për ndryshimin e shoqërisë audituese;
 - b. Shkaqet dhe arsyet e ndryshimit të shoqërisë audituese;
 - c. Dokumentacionin e përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.
2. Për ndryshimin dhe zëvendësimin e shoqërisë audituese zbatohen kriteret e përcaktuara në këtë rregullore

Neni 8

Raporti dhe opinionin i shoqërisë audituese

1. Në bazë të kontrollit të raporteve financiare për vitin ushtrimor, shoqëria audituese përgatit raportin dhe opinionin përkatës mbi këtë kontroll, të ushtruar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontrollit (auditimit).
2. Raporti i shoqërisë audituese i dorëzohet drejtuesve të shoqërisë administruese si dhe komitetit të kontrollit të brendshëm.

Neni 9

Publikimi i raportit të auditimit

1. Shoqëria administruese publikon në njërin nga botimet periodike financiare raportin e auditimit të jashtëm, brenda 15 ditëve nga data e miratimit nga asambleja e aksionarëve, por jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.
2. Raporti i auditimit i publikuar përfshin të paktën bilancin vjetor, llogarinë fitim-humbje për shoqërinë administruese dhe fondet që ajo administron, si dhe opinionin e shoqërisë audituese.

Neni 10

Procedura kontrolli

1. Shoqëria audituese bën vlerësimin e mjaftueshmërisë dhe të cilësisë të akteve nënligjore dhe të procedurave me të cilat operon shoqëria administruese dhe zbatimin e tyre. Kjo përfshin vlerësimin nga ana e shoqërisë audituese për:
 - a. Organizimin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të shoqërisë administruese;
 - b. Cilësinë dhe zbatimin e rregulloreve të brendshme të shoqërisë administruese për administrimin e aktiveve dhe pasiveve;
 - c. Organizimin e sistemit të teknologjisë së informacionit dhe koordinimin e tij me objektivat e biznesit dhe me ruajtjen e integritetit të të dhënave.
2. Shoqëria audituese kërkon paraprakisht dhe vlerëson opinionin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse të tij, për aspekte të veçanta të veprimtarisë së shoqërisë administruese.
3. Shoqëria audituese përgatit një raport në të cilin shpreh opinionin dhe vlerësimin e saj mbi rezultatet e nxjerra për organizimin dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë administruese mbi cilësinë e rregulloreve të shoqërisë administruese dhe zbatimin e tyre, të cilin e dorëzon tek drejtuesit e shoqërisë.
4. Shoqëria audituese duhet të kontrollojë, vlerësojë dhe të shprehë opinion mbi rregullsinë dhe saktësinë e raportimeve të dorëzuara pranë Autoritetit.

Neni 11

Dispozita të fundit

1. Shoqëria audituese miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare kryen kontrollin në të njëjtën shoqëri administruese më vete apo si pjesë e bashkimit të dy shoqërive audituese për një periudhë jo më të gjatë se katër vjet në vazhdim, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e shoqërisë administruese pas mbarimit të afatit kohor prej të paktën dy vjetësh.
2. Shoqëria administruese depoziton në Autoritet një kopje të raporteve të shoqërisë audituese së bashku me “Letrën për drejtimin” (Letra e menaxhimit) që shoqëria audituese përgatit për drejtuesit e lartë të shoqërisë administruese, si edhe vlerësimet e komitetit të kontrollit të brendshëm, të përgatitura sipas kërkesave të nenit 10, të kësaj rregulloreje apo çdo raporti tjetër të kërkuar, jo më vonë se afatet e përcaktuara në nenin 11 të Rregullores nr. 107, datë 30.06.2021 “Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të Sipërmarrjeve të

Investimeve Kollective, Shoqërive Administruese dhe Depozitarëve”, e ndryshuar dhe nenit 8, të rregullores nr. 123, datë 31.07.2024 “Për formën, përmbajtjen dhe afatet kohore të raporteve dhe pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore të shoqërisë administruese, fondit të pensionit privat dhe depozitarit”.

3. Përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (Departamenti i Mbikëqyrjes), të shoqërisë audituese dhe përfaqësues të shoqërisë administruese mund të zhvillojnë takime:
 - a. Para ose pas përfundimit të inspektimit të plotë të kryer nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare pranë shoqërisë administruese;
 - b. Në rrethana kur merren vendime të rëndësishme për shoqërinë administruese.
4. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejtë t’i kërkojë shoqërisë audituese çdo informacion mbi veprimtarinë e saj. Shoqëria audituese është e çliruar nga sekreti profesional në dhënien e informacionit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.